

KASEM TREBESHINA

# KRUJA E ÇLIRUAR

Dramë historike me 5 akte

R 6

S1

281-285



IA BOTONJËSE «NAIM FRASHERI»

Tiranë, 1953

8JH-2

JT 87

52

10303

KASEM TREBESHINA

8A-2

Tra 87

BIBLIOTEKE SHTETIT  
GJRMKU TIRANA

R

34466

# KRUJA E ÇLIRUAR

Dramë historike me 5 Akte



Tiranë,, 1953

Shtëpija Botonjëse "NAIM FRASHËRI,,

# SHOKËVE

ISHTVAN HORVAI

ARPAD BENEDEK

DANIEL LEON

me të cilët ndava frymëzimet e para, në  
shenjë kujtimi dhe dashurije, ua kushtoj.

A u k t o r i

## PERSONAZHET

Skënderbeu  
Hamzai  
I panjohuri  
Ambasadori i Parë  
Ambasadori i Dytë  
Plaku  
Plaka  
Shqiptarë të tjerë

Janosh Hyniadi  
Oficeri Plak  
Oficeri i Ri  
Arpad  
Oficer' të tjerë Hungarezë

Sulltan Murati i II  
Qatipi  
Vezir' i Math  
Hasan bez Vérzezhda rene-  
gat Komandant i Krujës  
Kara Beu  
Ismet Pashaj  
Eunuku  
Plaka turke  
Gjylnari vajzë turke nga  
nënë e krishterë  
Jolldëzi vajzë turke  
Oficerë, roje, dhe të tjerë.

## AKTI I PARË

(Bodrum i errët, i ndriçuar prej pishtarësh. Edrene) (Qatipi dhe rojet. Qatipi shitet nervoz. Nuk di ç' të bëjë. Dicka pret)-

- QATIPI : Hej ! thërritmani këtu shejtinan !  
(Hyn një turk i shoqëruar nga dy roje)  
TURKU : (I trëmbur) Urdhëro Hazretleri.  
QATIPI : Shiko, vezevul ! Se mos na ke tradhëtar ! ?  
TURKU : Aman Hazretleri, pas pak do të jetë këtu !  
QATIPI : Se mos më gënjen se ta rjep lëkurën e kokës !  
TURKU : Kurre nuk kam gënjer, Hazretleri ! —  
QATIPI : Se mos të kanë kuptuar ? —  
TURKU : Asnjëherë nuk kam bërë axhamillék, Hazretleri.  
QATIPI : Thyeje zverkun tashti, pa ta tregoj qejfin !  
(Rojet e turku dalin)  
QATIPI : T'i marrë djalli, sa po vonohen ! (Dëgjohen hapa) — Po vijnë më duket ! (Hyn një roje, dhe bën një nderim të ulët) E ? ... e sollët ? ! ...  
ROJA : Si urdhëron, Hazretleri.  
QATIPI : Futeni brënda.  
(Roja del, dhe pas pak sjellin një vajzë me fërrexhe. Vajza qëndron me kokën ulur përpëra Qatipit, dhe kontrollon bodrumin sikur kërkon dicka).  
QATIPI : Bija ime, mos u frikëso. Nuk do të të gjjejë asgjë e keqe. Për të mirën tënde i kurdisëm këto gjëra dhe këtë rrëmbim të gënjeshtërt. (U bën me shënje rojevet që të dalin menjëherë.) — Bija ime, jام babai yt në moshë, dhe ta dua të mirën. Unë e di të gjithë historinë e dashuris me prinçin e huaj . . . Mos u trëmb ! Nuk kam në mëndje të të bëj asnjë të keqe : dua vetëm të të ndihmoj për t' u ba-

- shkuar me lidhjet e shenja t' Allahut. Hapmë zëmrën, ti e do?... Fol! Pse hesht? Unë i di të gjitha prandaj është e kotë të m' i mëshehësh. Foli vet të gjitha se do t'iu ndihmoj, që të bashkoheni. Do t' flas vet Sulltanit përtty. Fol tashti: e do?!...
- JOLLDEZI : (Dridhet, me zë të mbetur) E dua.
- QATIPI : Ashtu më paç uratën. Tashti dëgjo : Do të dalësh në rrugë dhe porsa të vijë ay ftoje dhe së bashku hajdeni këtu...
- JOLLDEZI : (E trembur) Ja, jo! Nuk e bëj dot!
- QATIPI : Mos m' a pre fjalën!
- JOLLDEZI : Atë nuk e bëj dot!
- QATIPI : Do të bësh si të them unë! More vesh? Unë të dua të mirën dhe po të flas me të mirë! Po qe se nuk bindesh rojet jan tek porta!
- JOLLDEZI : (E trembur) Vram, po atë nuk e bëj dot!
- QATIPI : Do t'a bësh! Mjaft më! Në qoftëse nuk e bën nuk do të vrash siç kujton po të pret turpi. (Shef se e friksoi) — Ti do të bësh si të them unë, si thotë Allahu!
- JOLLDEZI : Aman Hazretleri, është turp e nuk e bëj dot!
- QATIPI : Një gjë që e urdhëron Sulltani, me gojën t'ime, mban vulën e Allahut para së cilës çduket çdo turp dhe hapen portat e Xhenetit.
- JOLLDEZI : (Kujtohet se është në gjendje të çuditëshme) E zeza, ku jam!? — Lëmë të lirë Hazretleri! Kthemëni atje ku më muarët se po e mori vesh im atë...
- QATIPI : Ke frikë, hë?! ... Asgjë nuk të shpëton dot nga kjo rrugë që ke zënë përveç miqësisë sime, more vesh? Vetëm unë mund të të shpëtoj. Ndihmomë Allah!
- JOLLDEZI : (Lutet me tallje) Ndihmo Allah skllevërit e tu!
- QATIPI : Allah il Allah! — Po unë zëmrën e kam të mirë. I dua zërrat e reja që digjen nga

dashurija dhe i ndihmoj me ç'më vjen dore.  
Sa<sup>je</sup> mora vesh punën tënde vrapova të të  
ndihmoj. Bija ime un e di zëmrimin e t'yt' eti.  
E kam mik dhe e njoh më mirë nga vehten.  
Zëmërimi i tij është i tmerrshëm, besomë. Unë jam  
babai yt'i dytë. Bija ime! Për mua ëshë lumturi  
të të bëj të lumtur! Dhe ti do të jesh e lumtur  
nëqoftë se më beson. Unë fatin tënd do t'a  
rrethoj me lule dhe me dritë! – Fol bija imel!  
Rugët e Xhenetit janë të hapura për ty! (E  
përkedhel me butësi) Fol vetëm një fjalë! Dorët  
zoja atit tënd fatin për t'a vendosur në Xhene-  
Më thoni Hazretleri, ç'të bëj?

JOLLDEZI :  
QATIPI :

(Mendohet pak) Tashti ai shkon në rrugë ; del.  
përpara dhe ktheje këtu. Ne do t'iu zëmë së  
bashku pastaj dashur pa dashur do t'ia ma-  
rrim lejen t'yt' eti – me mëshirën e Sultanit  
– dhe do t'iu martojmë. Ty të bije vetëm t'ai  
sjellësh këtu se të tjerat i rregulloj unë.

JOLLDEZI :  
QATIIP :

(Bije në gjunjë) Aman! Aman se është turpi!  
Mjaft! Do të iki nderi dhe koka. Zgjidh: ose  
vdekjen ose martesën. Shko! – (Jolldezi matet  
të shkojë) – Ashtu paç bekimin e Allahut dhe  
uratën time. (Jolldezi ndalet) Ec! Shko drejt fa-  
tit tënd (Jolldezi del. Qatipi e shoqëron gjer  
te dalja. Përplas lehtë duartë dhe hyn roja që  
pruri Jolldezin) Ndiqe pas dhe në rast se mun-  
dohet t'iki vraje në vënd bashkë me tjetrin.  
Mos harro të më njoftojsh me një herë. (Roja  
thotë: "Si urdhëron" – dhe del) – Tashti Ismet  
Pasha do të shohësh se si e marr hakun e  
çupës s'ime që zbukuroi shtratin e natës së  
Kadrit.

QATIPI :  
TURKU :

Ej! Shejtan !!

(Hyn Turku me dy roje)  
Urdhëro, Hazretleri !

- QATIPI : E di e kujt ishte kjo çupë ?  
 TURKU : E Ismet Pashait, Hazretleri !  
 QATIPI : Po e di ti qën, se kush është Izmet Pashai ?  
 TURKU : Hazretleri ! . . . . . Hazretleri ! . . . . .  
 QATIPI : Fol qën !  
 TURKU : Hazretleri ! . . . Hazretleri, ti më the . . . . .  
 QATIPI : (Me zë të mbytur, si një tigër që lot me viktimën e tij) Unë – të thashë – se donja – të të provoja – i poshtër !  
 TURKU : Ti qën – duhet – të njohej-radhën-tënde ! (Vazhdon duke i ndarë fjalët dhe më zë të mbytur) Edhe nëpër mënd nuk duhet të të shkojë të prekësh qoftë edhe çallmën e një Pashai ! (Fortë edhe sikur e pret me shpâtë) Merreni ! – (Me dorë bën shënjën e prerjes së kokës) Le të flerë me peshqit.  
 (Dalin dy rojet me turkun mbërthyer kokë e këmbë. Turku del duke bërtitur por shpejt shuhet zëri i tij).  
 QATIPI : (Shkon dhe pas pak këthehet me një njeri. E vendos tek cepi i bodrumit n'errësirën më të thellë.) – Këtu prit dhe mbaro punë. Mos harro se po nuk më dhe kokën e tij unë dua tënden !  
 XHELATI : Mos ki merak Hazretleri,  
 QATIPI : (Dëgjon zhurmë) Pellumbat po vijnë më duket. Unë po fshihem këtu pranë. Mos haro se dua kokën e tij ose tënden,  
 (Qatipi shuan pishtarin dhe zhduket në bodrumin pranë. Hyjnë pa u dalluar Jolldezin me të huajin. Ndihet frymëmarrja e rëndë e të dyvet).  
 I HUAJI : Ku më çon e dashur ?  
 JOLLDEZI : Këtu shpirt.  
 (Errësirë. Dëgjohen të puthurat . . . Një klithëm e shoqëruar nga një e dytë, dhe dy rrëzime).

- QATIPI :** Hyjnë rojet dhe Qatipi me pishtar. Në dyshe-  
 me i vdekur éshtë i huaji dhe pranë tij e  
 shtrirë pa ndjenja, Jolldezi. Në këmbë xhelati).  
 Nxirreni të vdekurin pérjashta dhe lajmëroni  
 të vijë Ismet Pashanë. – (Qatipi del. Rojet nxjer-  
 rin jashtë të vdekurin dhe mbetet vetëm një.  
 Jolldezi vjen *në* vehte.)
- JOLLDEZI:** Ku éshtë ? Ku éshtë . . . ? (Matet të dalë, por  
 nuk e lë roja). – Lërmë, lërmë ! . . .
- ROJA :** Hanëm mos bëni zhurmë pérndryshe do t'ju lith.  
**JOLLDEZI:** Ç'e bëtë ? . . . Ç'e bëtë ? . . . Ah katila! . . .  
 E mjera unë! . . . Katila ! . . . Mizorë! . . .  
 (Hyn Sulltani në inkonjito me Qatipin dhe shumë roje).
- JOLLDEZI:** Katila ! . . . Katila . . . . Ç'e bëtë ! E mjera  
**SULLTANI:** Nxireni jasht.  
 (Jolldëzin e nxjerrin jashtë ndërsa vazhdon të  
 bërtasi: Katila . . . Katila ! . . . – Në shenje të  
 Sulltanit të gjith largohen.)
- SULLTANI:** Eh, si ndodhi Qatip ? Nuk më bëre të prisja  
 shumë
- QATIPI:** Pér mrekulli Padishah. Si mbas urdhërit tuaj  
 të lartë mora të gjithà masat pér t'a vrarë.  
 Vura njerzit që t'a vrisin kur të kalonte dhe po  
 prisnja. Kur papandehur e bija e Ismet Pashait i  
 dolli pérpara dhe diçka i foli. Pasi këmbyen  
 disa fjalë me zë t'ulët u zunë pér krahu dhe  
 erdhën këtu. Këtu atë e vranë dhe pëllumbeshën  
 e arrestuan.
- SULLTANI :** Lajmëroni Ismet Pashanë që të vijë.  
**QATIPI :** E kam lajmëruar  
**SULLTANI :** Ashk Ollsun të qoftë.  
 (Pushim)
- QATIPI :** Padishah po tjetri  
**Sulltani :** Tjetri duhet t'a ketë harruar vëndin e tij.  
**QATIPI :** Nuk më duket Padishah. Njerëzit si ai nuk e

harrojnë lehtë vendin e tyre. Zor që të kuptohet ai njeri. E ka mbyllur shpirtin dhe asgjë nuk lejon të duket, më sa duken këmbët e gjarpërít. Nuk mund të thotë njeri se e ka mik e aq më tepër se e ka armik.

SULLTANI: Ç'bën ai njeri ?

QATIPI: Mëson Padishah. Dhoma e tij është si dhomë ulemau ose të paudhi.

SULLTANI: Skënderbeu më duhet, dhe do të mjaftohemi vetëm duke e ruajtur.

QATIPI: Kam frikë Padishah.

SULLTANI: Nuk ke përse të kesh frikë. Vetëm ruajeni, a more vesh ?

QATIPI: Si urdhëron Padishah

SULLTANI: Ai është shtyllë e imperatoris dhe shumë i vlefshëm. Na duhet dhe do t'a mbajmë.

QATIPI: (Si me vehte) Padishah vetëm duhet kujdes se mos bëhet vonë kur të mos na duhet!

SULLTANI: (Mendohet) Ke hakë. Duhet që me mënyra të tërthorta t'a provojmë besnikërinë e tij.

(Hyn Ismet Pashai. Nderon thellë).

SULLTANI: I more vesh punët e bukura që kanë ngjarë?

ISMETI: Jo, Padishah.

SULLTANI: T'ët bijë e zunë në këtë vënd të mëshehur me një prjnc të huajë, të pa besë. Jot' bijë do të vdesë!

ISMETI: Nuk më besohet që t'a ketë bërë Padishah.

SULLTANI: E bëri, zgjebarak, e bëri! Dhe do të vdesë menjë herë.

ISMETI: Në e bëri le të vdesi. Gjaku le të bjeri mbi kokën e fajtorit!

SULLTANI: Silleni fajtoren mbrenda!

(Rojet fusin Jolldëzin fare të humbur dhe e vënë më gjunjë).

SULLTANI: Gjynahqare, do të vdesësh. Ti shkelle ligjin e Allahut dhe e ndyve fenë tonë të lartë. Ti do të

- vdesësh si gjynahqare !
- JOLLDËZI : (E çmëndur) Ç' e bëtë, e mjera ! ? ... Qofshi të mallkuar ! ... Qofshi të mallkuar ! ...
- QATIPI : Është çmëndur !
- SULLTANI : T'i pritet koka me një herë !  
(Jolldëzin e nxjerrin jashtë ndërsa thotë : «Qofshi të mallkuar ! ... Ç' e bëtë ! Ç' e bëtë. . . E mjera ! . . . Qofshi të mallkuar ! . . . »)
- ISMETI : Padishah, më lejoni ?
- SULLTANI : Shko.  
(Ismet Pashaj del i shoqëruar me sy nga Sulltani dhe Qatipi. Ndihen hapat dhe një rrëzim në shkallë).
- ROJET : (Hyn) Pashai vdiq në shkallë.
- SULLTANI : Shpjereni në pallatin e tij (Sulltani u bën shenj dhe rojet dalin) — Si t' ia provojmë tjetrit besnikérin ?
- QATIPI : Shumë kollaj Padishah.
- SULLTANI : Si ?
- QATIPI : Thërrite dhe njoftoje mbi gjëndjen në Shqipri ...
- SULLTANI : Mjaft ! Shko tashti !  
(Qatipi nderon dhe del. Sulltani qesh) — Grackë e bukur ! Ky qën qëni shum mirë i gjen këto gjëra. E provojmë. Tashti do të shkoj. Mjaft shetita natën : shtrati po më pret !

P e r d j a

## AKTI II-të

### Skena e parë

Rrugë në Endrene. Një njeri i reckosur shesh që dikush afrohet dhe tërhiqet n'errësirë. Hyn një oficer i lartër i ushtrisë turke dhe njeriu i rreckosur i del përpara.

NJERIU : Gjergj!

GJERGJI : (Shikon rrotull dhe e kap për fyt) Kush je ti që përmënd një emër të cilin unë vetë kam harruar ka kohë!

NJERIU : Unë jam ai që vjen e t'a kujton pë-r të mos e harruar.

GJERGJI : C' do ti?

NJERIU : As' gjë me tepër nga c'kérkon Atdheu dhe nderi!

GJERGJI : Prej nga vjen?

NJERIU :

GJERGJI : Mos jam unë guri i tij?

NJERIU : Ai, kú ti shérben!

GJERGJI : (E térheq më në errësirë) Prej nga vjen?!

NJERIU :

GJERGJI : C' kemi nga Shqipërija?

NJERIU : Dëgjoi po munde pa u trondit! Yt' atë vdiq dhe pa i myllur mirë sytë, një ushtri turke e zuri kështjellën. Si sundonjës u bë Hasan Bej Vérzexhda. Mëma dhe motra Mamica po vuajnë një mizerje. Tmerri mbretëron kudo. Në Myzeqe turqit bëjnë piramidha me koka njerzësh. Pas kryengritjes së Depes dhe Arianitit, edhe një herë gjithë Shqipërija u shkri në zjarr dhe hekur. Mjaftë! Ne nuk durojmë më! Njerzit shkojnë me qindra nën thikë si berrat nga vatha. C' presim? Kur të mbarohemi të gjithë të ngrihem? Shpatat t' ona kanë mbetur

- për t'u hakruar me to, grave dhe kalamanëve.  
 Në do t'i provojmë edhe një herë armët t'ona:  
 Po të duash eja udhëhiqi!  
**GJERGJI:** Po ç' mund të bëjmë me një grumbull njerzish  
 kundra një ushtërije të organizuar, që ka në  
 dorë gjithë fortesat e vëndit tonë?  
**NJERIU:** Ato janë ushtëri të organizuara, po ne jemi  
 burra, Shqiptarë!  
**GJERGJI:** Ata kanë kalatë ku fshihen?  
**NJERIU:** KALATË janë t'onat dhe do ti marrim!  
**GJERGJI:** Pa topa?  
**NJERIU:** Malesorët dy metro të gjatë dhe fusharakët  
 gjoks gjëre janë më tepër se topa!  
**GJERGJI:** Nuk kemi as' armë të mjaftueshme.  
**NJERIU:** Kockat e të vdekurve do të na mjaftonin dhe  
 tepëronin!  
**(dëgjohen hapa)**  
**GJERGJJ:** Shëtl...  
 (Tërhiqen n'errësirë. Hyjnë dy pijanecë, njëri rë-  
 zohet, tjetri e ndihmon të ngrihet)
- I PARI: E gjérë eshtë kjo botë.  
 I DYT: Dhe e gjatë sa ushqen të mirë dhe të liq.  
 I PARI: Thonë se njerzit i ushqen kau.  
 I DYT: Nuk e kanë keq, se njerzit janë katandisur  
 më keq se qetë.  
 I PARI: Vëtëm se qetë hanë barë, kurse njerzit  
 bukë.  
 I DYT: Pa ngrohen nën këtë Hënë që na ndrit.  
 I PARI: E ke gabim or mik: Ky eshtë Dielli.  
 I DYT: E ke ti gabim, kjo eshtë Hëna Turke që  
 kërkon të ngrohë gjithë botën (rëzohet)  
 I PARI: Dielli eshtë Dielli. (Mundohet t'a ngrejë). Kalon  
 ne këtë kohë një pianec i tretë). Or mik! Or-  
 mik na ndaj, një sherr: Dielli eshtë ky që na  
 ndrit apo Hëna?

- TRETI; Të të them të drejtën unë jam nga Persija.  
(Del)
- I DYTË; (ngrihet) Hënë o Hënë! në këtë kohë nën ty  
sa gjëra bëhen!
- I PARI; Dielli Dielli!
- (Dalin. Hyn një djal' i ri, me një mjekër të zezë  
të rrallë, me një çallëm të lehtë e me turban të  
bukur. Është i fryshtuar dhe i mban duart drejt  
qiellit në mënyrë të çuditëshme. Duket se është  
Poet).
- POETI; Ah, sikur t' ishin yjtë vargje  
faqes së qiellit nderë,  
të nda' nga larg do t' i shikonim  
siç shihnim yjt' një herë! —
- Ah, sikur t' ishin yjtë lule  
t' i shihnja bashkë me ty,  
Me vargj' e lule, do të flisnim  
ato që s'tham të dy! —
- (Del me nxitim i frikësuar se dëgjoi zhurmë. Hyn  
një roje me pishtar në dorë dhe pas tij vijnë  
roje të tjera dhe vargp leqësh e grash me fëmijë  
në krahë. Një plak rëzohet nga vuajtja dhe rën-  
dësira e vargonjve)
- NJË ROJE; Ngreu qen!  
(E qëllon me kamzhik. Zhurmë në masë. Plaku  
grumbullon fuqit e fundit dhe ngrihet. Vargu vazh-  
don rrugën dhe dalin përmes kamzhikëve. Pas tyre  
në fund të kollonës, një roje me pishtar).  
(Gjergji dhe njeriu dalin pak nga errësira)
- GJERGJI; Ti the se jeni gati për t' ù ngritur?  
NJERIU; Pol!

- GJERGJI: Dhe se më nderoni duke ma besuar mua udhë heqjen?
- NJERIU: Po!
- GJERGJI: Prisni urdhërat e mijë dëshironi gati. Unë së shpejti do të jem në mezin t' uaj!
- NJERIU: Ne e dinim se gjaku uj nuk bëhet.
- GJERGJI: Vetëm ke ardhur?
- NJERJU: Vet' i dytë!
- GJERGJI: Tashti shko se po të qëndrojmë më gjatë së bashku rrezikohemi. Mos u largoni pa urdhërin tim. Mbani lidhje me Hamzanë. (Shqiptari del) Im' atë vdiq. Tashti puna është e kcarte. Do të njihemi!
- (M' atet të dalë kur një tufë lulesh i bije përpara i shikon me çudi)
- GJYLNARI: (Nga dericka e kopështit fqinjë) O Arrnaut i bukur, shpres e shpresës sime, lidhi sytë dhe në këto anë të kafazeve!
- GJERGJI: Nuk ju kuptoj, hanëm.
- GJYLNARI: Mos vallë syt' e tu nuk shohin?
- GJERGJI: Syt' e jeniçerit shohin vetëm sheshin e bëtejës.
- GJYLNARI: Dashurija nuk bën dot fole në zemrën tënde?
- GJERGJI: Dashurija nuk e njeh miqësinë me zëmrën e jeniçerit.
- GJYLNARI: Je i egër si malet tua!
- GJERGJI: Nuk ju kuptoi hanëm se për çfarë malesh flisni. Unë jam jeniçer!
- GJYLNARI: O Arrnaut i bukur, zemra e jote rreh për vënde të largëta dëshironi gati. Po kij mëshirë, se prapa kafazeve rrabin zemra që kërkojnë të fluturojnë të lira si dallandyshet në qiellin e pastër Pranveror.
- GJERGJI: Unë jam jeniçer hanëm. Ajri është i Padi-

shahut dhe dallandyshet nuk fluturojnë pa urdhërin e tij.  
GJYLNARI: Mos është thënë që mushkëritë e njoma të kalben në haremë?  
GJERGJI: Unë jam jeniçer hanëm  
GJYLNARI: Dhe kur gjoksi buçet si valët në grykën e Bosforit? !  
GJERGJI: Edhe ato i binden Padishahut.  
GJYLNARI: Kij mëshirë, O Aronaut i bukur, për zemrat e mjera që përpeliten në llomin e haremeve!  
GJERGJI: Edhe mëshira është në dorën e Padishahut.  
GJYLNARI: Oh, duam tufan i tërbuar!  
GJERGJI: Unë jam jeniçer hanëm, çdo gjë ka mbaruar.  
GJYLNARI: Atëhere ndrit moj flak' e pa shuar!  
Digju shpirti im si digjet kjo botë se çdo përpjekje qënka fare e kotë!!!

### P e r d j a

#### Sken' e dytë

#### S a l l è e P a l l a t i t.

Sulltani dhe oborrtarët.—

(Hyn Skënderbeu, nderon)

SULLTANI: Biri im, shumë kohë ka që nuk të kam parë dhe më mori malli.  
SKËNDER: Po kjo ndodh edhe tek unë më me shumë fuqi, me vullnetin e Padishahut.  
SULLTANI: Dua ta kem parasyve fitonjësin e sa betejave, ngulësin e flamurit me hënë në Anadoll!

- SKENDER : Nuk më bie mua nderi për këtë, Padishah.
- SULLTANI : Po kujt?
- SKENDER ; Flamuri u ngul me vullnetin e Zil-allahut.
- SULLTANI ; Vërtet po Zil-allahu e nguli me dorën tënde. (Heshtje). Biri im, do të njoftoj lajme jo të mira.
- SKËNDER : Zemra e jeniçerit nuk tronditet para asnje lajmi sa do i hidhur që të jetë.
- SULLTANI : Ashtu vërtet, po kur na njoftojnë se vdiqën ata që na lindën (e shikon duke e kontrolluar me imtësi) nuk mund të qëndrojnë si gur.
- SKËNDER : (Me marifet tregon dhëmbje të përbajtur) E rëndë është Padishah! Zemra e njeriut goditet për një çast!
- SULLTANI : Ke të drejtë, biri im, ke të drejtë. Zemra është zemër!
- SKËNDER : Falma tronditien Padishah! U gjet një vënd kaq i dobët ne zemren time!
- SULLTANI : Edhe jeniçerët para së gjithash janë njerëz!
- SKENDER ; (Bën sikur e mbledh vehtën) Jeniçerët nuk i kanë lidhur njerëzit Padishah!
- SULLTANI : Po kush?
- SKENDER : Hazreti Osmani, Zil-allahu!
- SULLTANI : Po megjithata hazreti Osmani i pregetiti me njerëz të lindur nga femrat.
- SKENDER : Me gurë mund të bëhet çolloj kalaje Padishah.
- SULLTANI : Po mos harro se pa gurë nuk bëhet as kala-ja dhe as pollati. Sidoqoftë, duke mos marrë parasysh dashurinë e madhe që kam për ty, më duhet të të njoftoj, se, si pas urdhërit të allahut – i qofshim falë – yt' atë Gjoni ndërrroi jetë.
- (E vëmeren kujdes po Skëndërbeu tashti e ka në dorë rrjedhjen).
- SKENDER : Mos humbëm ndonjë betejë? Mos ra ndonjë

- flamur në dorë të armikut? Mos hëna ndërrroi rrugën e sajë?  
**SULLTANI :** Megjithëse për ushtarin sendet që rradhite janë shumë të shtrenjta, prindërve iu detyrojmë jetën tonë.  
**SKËNDER :** Jetën tonë ia detyrojmë Zil-allahut.  
**SULLTANI :** Si djalë që të kam, e kam për detyrë që t' a lehtësoj sa më shumë hidhërimin. Tashti principatës së Shqipërisë i mungon sundonjësi. Me gjithë shpirt jam gati të t' a jap, pa marrë parasysh hidhërimin që do të më shkaktojë largimi yt.  
**SKËNDER :** Mos Padishahu u rëndua nga unë?  
**SULLTANI :** Aspak.  
**SKENDER :** Mos u gabova në shërbim?  
**SULLTANI :** Përkundrazi ke qenë gjithnjë në rregull.  
**SKENDER :** Po atëhere përsë Zil-allahu të më japë një dënim kaqë të rëndë?  
**SULLTANI :** Mos është dënim të dhurosh principatën e Shqipërisë?  
**SKENDER :** Padisha! Jeniceri ka vetëm një dëshirë: t'i shërbëjë Padishahut. Gjërat më të shtrenjta për të janë shpata dhe çadra.  
**SULLTANI :** Si të duash. Vetëm mos harro se unë me gjithë zemër, pa marë parasysh hidhërimin e ndarjes nga ti, t' a dhurova principatën e Krujës dhe të Matit.  
**SKENDER :** Mëshira dhe zemërmadhësija e Padishahu na çfagen në çdo gjë.  
**SULLTANI :** Sidoqoftë tashti akoma nuk është vonë: fol!  
**SKËNDER :** Me lejen e Padishahut fola.  
**SULLTANI :** Mos do kohë për t'u menduar?  
**SKENDER :** Jeniceri nuk ka nevojë për t'u menduar, Padishah.  
**SULLTANI :** Atëhere për të shpërblyer besnikërinë tënde nuk mbetet veçse një rrugë.

- SKENDER : Mos nuk éshtë i mjaftë nderi i emërit të jeniçerit,  
 Padisha?
- SULLTANI : Megjithëatë, po të dëshirosh, jam gati t' a  
 ndryshoj me urdhërin e allahut – vëtëm për  
 ty, ligjin e jeniçerit.
- SKENDER : Nuk kuptoj Padisha!
- SULLTANI : Në qoftë se t'a dëshiron zemre të shijosh fem-  
 rën, je i lirë.
- SKËNDER : Unë jam jeniçer, Padisha.
- SULLTANI : Do të të dhuroj një pallat. Atje t' a mbash  
 dhe të gézohesh
- SKËNDER : Padisha, me lejen tuaj, më parë e fus shpatën  
 gjer në mill në zemër, se sa të ndynj emërin  
 e jeniçerit.
- SULLTANI : Femrat na i mbushin zbrazësirën e jetës.
- SKËNDER : Jeniceri nuk; éshtë kurrë i vetëm: ai rron me  
 lavdinë ushtarake dhe me emërin e tij pa të  
 cilat nuk ka të drejtë të jetqëjë.
- SULLTANI : Shumë mirë, shumë mirë. Besnikerinë tënde do  
 t'a shpërblej me grada ushtarake. Shko tashti  
 biri im, dhe allahu qoftë me ty. Mos harro të  
 vish përherë.
- SKËNDER : Me lejen e Padishahut!  
 (Nderon dhe del.)
- SULLTANI : (Oborrtarëve) Po ju ç' doni? Thyeni zverkun  
 genër-qënsht!
- (Të gjithë dalin duke bredhur nga frika. Hyn Qa-  
 tipi dhe nderon thellë).
- SULLTANI : Ç' kemi Qatip?
- QATIPI : Skënderbeu, Padishah, mbrëmë; kur po shi-  
 konte ushterinë u takua me një njeri rrecko-  
 sur. Mund të ishte lipës.
- SULLTANI : Biseduan gjë?
- QATIPI : Nuk mundën t'i dëgjonin Padishah.
- SULLTANI : Pse?

- QATIPI : Se prapa tij ishte Hamzai Padishah, dhe nuk afroheshin dot që të shihnin më mirë.  
 SULLTANI : Qënër-qëns! Për asgjë nuk jeni të zotët!  
 QATIPI : Padisha, me gjithatë, njerëzit tanë nuk e bëjnë aq keq punën. Ata e njohën njerinë e dytë me të cilin foli Skënderbeu.  
 SULLTANI : Kush ishte qën e bir qëni! Tregoi shpejt e të gjitha zagar i ndyr se do të të var!  
 QATIPI : Bis edoi me të bijën e Sinan Pashait Padisha bijën e robinës së zënë në Ballkan.  
 SULLTANI : Ashtu! ? .... Ç' folën ? !  
 QATIPI : Nuk mundëm t'i dëgjonim Padishah, vetëm pamë që ajo i hodhi një tufë me lule, po ai nuk i mori. Kjo pa tjetër do të ketë qënë isharet.  
 SULLTANI : Ah, Arrnaut! Mendon se më gënjeve po ga-bohe! — Qënka rritur çupa e Sinan Pashait?  
 QATIPI : Ajo është grua tashti: 16 vjeç.  
 SULLTANI : Ik tashti !  
 (Qatipi nderon dhe del. Sultani përplas duartë.  
 Hyn Enuku.)  
 SULLTANI : Ç'ke menduar për shtratin e Podishahut?  
 ENUKU : Një vajzë 13 vjeç nga Rumelija Padishah.  
 SULLTANI : Të lihet për tjetë-r ditë. Për ditën e Nevruzit dua që shtratin tim t'a mbushë e bija e Sinan Pashait. More vesh? Hajt! thyeje zverkun tashti (Enuku del.)  
 SULLTANI : (Vetëm. Fërkon mjekrrën.) O thëllëzë e njomë, pa të shohim se çfarë gjëllë ka pjata jote!  
 (Hyn me shpejtësi Veziri i madh) Ç' është? Fol!  
 VEZIRI : Lajmëtar nga Ballkani; Padishah!  
 SULLTANI : Le të hyjnë!  
 (Hyn një bej dhe pas tij Qatipi me oborrtarët. Beu bën një temena të gjatë e të rëndë dhe i dorëzon sultananit fermanin)

- SULLTANI : (E çel me të shpejtë) Hë, hë!... Hungarezët.. Duan një mësim që t'u mbushet mëndja se Europa dhe Azija janë të mijat. Luftë kërkojnë luftë do t'u japim! (E flak fermanin dhe shitet si i tërbuar nëpër sallë. Të gjithë dridhen nga frika e tij. Heshtje. Sulltani vete të shiltet.) Nga vëndet e tjera ka gjë ?
- VEZIRI : Kudo mbretëron qetësija, Padishah.
- SULLTANI : Atëherë me të gjithë ushterinë do të shkoj kundër këtij Hyniadit. Si pararoje do të nisen Karabeu me Skënderbenë me njëzetmijë vetë. T'i pritet rruga Hyniadit në Beograd ose më larg akoma, gjersa të vij vetë.
- VEZIRI : Si urdhëroni Padishah.
- SULLTANI : (Mendohet.) Dërgoni të thérresin Skënderbenë.
- QATIPI : Është jashtë Padishah dhe po bisedon me disa oficerë.
- SULLTANI : Lajmërojeni të vijë. (Oficeri i shërbimit del. Sulltani qesh me inat). Allah, tregoje forcën në hijen tënde! (Hyn Skënderbeu dhe nderon.) Biri im, do të nisesh në Ballkan kundër Hungarezëve.
- SKËNDER : Padisha, mos më bëni të turpërohem! Ballkani është një vënd të cilit nuk ia di mënyrën e luftimit. Pastaj për Komandantin Hungarez duhet ndonjë komandant më i zoti se unë.
- SULLTANI : E di unë sa vlen Hungarezi para teje Shqiponjë Osmane! Vullneti im është që të nisesh me një herë për në Ballkan dhe, së bashku me Karabenë, t' a ndaloni Hyniadin sa më larg. Kaq. Vullneti i Padishahut tim është për mua gjëja më e lartë!
- SULLTANI : Bëhu gati sa më shpejtë dhe nisu me ndihmën e Allahut.
- SKËNDER : Si urdhëron Padishah. (Nderon dhe del.)

- SULLTANI : (Vezirit). Bëje gatí fermanin për nisjen e parorojes!
- VEZIRI : Si, urdhëron Zil-ullah.
- SULLTANI : Ti Qatip do; të shkosh me Skënderbenë, more vesh ?!
- QATIPI : Si urdhëron Padisha.
- SULLTANI : Shporruni, qënër e bij qënsht !  
 (Sulltani ngrihet. Të gjithë shpërndahen në anë të ndryshme e në skenë mbetet Qatipi me Sulltanin.)
- SULLTANI : Shiko Qatip ! Ti nuk do të kontrollosh vetëm Skenderbenë. (Qatipi shikon dhe nuk kupton gjë). Kunati im ka nevojë për mua !
- QATIPI : Nuk kuptoj Padishah !
- SULLTANI : Gjithnjë i trashë ke qënë !
- QATIPI : Baltë e këmbëve të tua !
- SULLTANI : Kunati im Brankoviçi ka nevojë për mua. Hyniadi po shkel në tokat e tij dhe duhet t'i paguajë gjobën.  
 Pérndryshe Brankoviçi më paguan mua gjobë ! Dikur në fushën e Kosovës Sulltan Muratin e Parë e ka vrarë një bari sërb. Një Millosh tjetër duhet të na i lajë këtë se Hyniadi ka shkelur tokën e tij.
- QATIPI : Kuptoj Padishah.
- SULLTANI : Gjerg Brankoviçit s'i kemi marrë pajë. Le të na japë gjakun e Hyniadit, kuptove ?
- QATIPI : Kuptova Padishah.
- SULLTANI : Ç' mendohe ? !
- QATIPI : Mendoj planin Padishah.
- SULLTANI : Mendohu sa të duash po unë dua gjakun e Hyniadit. Merr vesh ? !!
- QATIPI : Si urdhëron Padisha.  
 (Sulltani del. Qatipi nderon përulësisht.)
- QATIPI : Nuk i turpëroj thnjat e mijë. Më duket se po i afrohem shiltes së Vezirit Allah il allah ! –

## AKTI I III-të

(Rrugë në Edrene. Duket bregu i lumit dhe përbollë qyteti dhe minaretë. Hyn Skënderbeu me Hamzan, kur përbollë takohen me Karabeun.)

KARABEU: Për tek ju u nisa.

SKENDERBEU: Edhe unë. Besoj ju njoftuan se kundër të pabesëve do të shkojmë së bashku.

KARABEU: Ma dorzuan fermanin.

SKENDERBEU: E ke preqatitur planin e fushatës ?

KARABEU: Shum gjëra kam menduar, por duhet patur parasysh se çdo gjë varet nga fakti se sa ka përparuar kundërshtari.

SKENDERBEU: Unë mendoj se përparim' i math i kundërshtarit na vë në pozitë të keqe, sepse mund të ngrihen banorët e vëndeve që sot janë me ne dhe të bashkohen me Hyniadin.

KARABEU: Ashtu mendoj edhe unë.

SKENDERBEU: (Përnjëherë) Ku mendoni që t'i presim ?

KARABEU: Unë . . . . mendoj . . . . Unë mendoj që nëpër Bullgari të kalojmë shpejt e shpejt dhe t'i presim nga Danubi ose nga malet Ballkan.

SKENDERBEU: Të të them të drejtën plani është shumë i mirë dhe mua më pëlqen shumë, Por . . . . (bën sikur mendohet) Sikur t'i binim për mes Maqedonis ? . . .

KARABEU: Ishje te Padishahu ? . . .

SKENDERBEU: Po.

KARABEU: Zil-Ullahu tha gjë ?

SKENDERBEU: Këtë do të thoshja dhe unë, Urdhëroi që me shpejtësin më të madhe, nëpër mes Maqedonis t'arrijmë para Hyniadit n'afërsit e Beogradit ose në Nish të paktën.

KARABEU: Shumë mirë për Allah, shumë mirë.

SKENDERBEU: Për çdo lehtësi me ne do të jetë dhe Qetipi.

KARABEU Unë mendoi se do të jetë më mirë që të merrimi vesh me njëri tjetrin, për çdo pünë ushtare, se Qatipi nuk para mer vesh nga lufta, dhe do të na pengojë më shumë se sa do të na ndihmojë.

SKËNDERBEU: Në përgjithësi mund të na ndihmojë, me përjashtim të ndonjë rasti thjesht ushtarak, por megjithatë, me qënë se ju thoni që merremi vesh në mes nesh, ne merremi vesh në mes nesh.

KARABEU: Po po, edhe unë për atë tash,

SKËNDERBEU: Atëherë me një herë të fillojmë nga veprimi. Unë mendoj të nisim, si fillim të fushatës, një trupë të fortë para-roje e cila do të nga spastrojë rrugën nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, si një trupë e vogël, mundësi që të lëvizë lirisht dhe më shpejt. Ajo do t'a pengojë Hyniadin në veprimet e tij. Ne kjo gjë na lejon që t'a godisim ushterin ormike në pozita që i kemi zbuluar më parë.

KARABEU: Shumë plan i bukur, për Allah.

SKFNDARBEU: Nëqoftëse e pranoni, unë mendoj që këtë detyrë t'ia ngarkojmë Hamzait. Karabej, ti vet e di se si i përbush detyrat Hamzai.

KARABEU: E di Skënderbej, e di. Plani është i bukur dhe unë nuk kam asnje kundërshtim. Vepro sa më parë.

SKËNDERBEU: Nisu Hamza, dhe ti e kupton pse duhet shkuar andej!

HAMZAJ: Si urdhëron!

SKËNDRBEU: Atëhere me mënd dhe dalshim faqe-bardhë.

(Hamzaj përhëndet dhe del)

SKËNDERBEU: Tashti bej, përpara në veprim.

KARABEU: Vepro Skënderbej, vepro!

SKËNDERBEU: Fitorja më së fundi do të jetë, e jona.

(Përshëndeten dhe ndahen. Karabeu kthehet prap andej nga erdhi, ndërsa Skënderbeu e shoqeron me sy, me një nënqeshje ironike. Kur në këtë kohë hyn në skenë Gjylnari e veshur si djalë dhe qëndron prapa Skënderbeut.).

**SKËNDERBEU:** Vetëm një fitore e plotë e Hyniadit na jep kohë t'i marrim kalatë dhe t'organizohemi.

(Dallon Gjylnarin)

**GJYLNARI:** Mbarova Arnaut, mbarova! Po më kërkojnë rojet dhe Eunuku!

**SKËNDERBEU:** Ç' janë këto Hanëm?!

**GJYLNARI:** E kuptoj qëndrimin t'ënd. Ti kujton se ke para teje një vajzë mëndjelehtë. Ti kujton se ke përpara femrën e përbuzur që është mësuar të shkryhet nëpër haremët!?

**SKËNDERBEU:** Asgjë nga këto nuk mar vesh, Hanëm!

**GJYLNARI:** Ti i kupton të gjitha, por ikim, ikim nga ky vënd i mallkuar!

**SKËNDERBEU:** Ky është vëndi ku sundon Hija e Allahut

**GJYLNARI:** Hija e Djallit sundon!

**SKËNDERBEU:** Ky është vëndi ku kemi lerë.

**GJYLNARI:** Burku ku lindim!

**SKËNDESBEU:** Nga ky vënd ishte nëna që ju lindi.

**GJYLNARI:** Nga ky vënd ishte im' më? Jo, jo! Për ne gratë nuk ka as nënë, as atë, as vënd, as qiell, as tokë, as det! Ne jemi kafshëza, ose më mirë plaçka, për të bërë të këndëshme për Padishahùn dhe burrat ditët e shënúara. Merrmëni ju Arnaut!

**SKËNDERBEU:** Unë jam Jenicer. Hanëm.

**GJYLNARI:** Njeri i gûrtë, beson se ka dashuri në botë?

**SKËNDERBEU:** Mundet

**GJYLNARI:** Ka. Njeriu një zëmër ka dhe këtë dûhet t'a dhurojë vetëm njëherë. Unë t'a dhurova ty

t' imen: merre Arnaut!

SKËNDEBEU: Unë jam ushtar, Hanëm.

GJYLNARI: Oh! mëshirë, mëshirë! Më duaj më pak se sa tē dua! Mos më braktis! Mos më lërë tē tretem Haremeve! Mos kam faj që tē dua? Mos kam faj që linda femër? Mos jemi tē mallkuara? Jo, jo, Ti nuk do tē më braktisësh në në errësirën e Haremeve! Nuk do tē më lësh! Ikim Arnaut, ikim!...

SKËNDER: Hanëm, unë po nisem për në luftë!

GJYLNARI: Ikim zjarr i pashuar! Ç'na duhet lufta? Mos kujton se janë fjalë vajze tē pa pjekur? Jo! Tē flet sorkadhe plagosur për t'a shpëtuar dhe që me zjarr tē dashuron. Unë jam nga ky vënd! T' im më e kishin marë plaçkë lufte. Ajo më ka treguar shumë gjëra për vëndin e saj! ... Ikim... Me ty jam gati tē shkoj edhe në fund tē botës.

SKËNDER: Kudo sundon pedishahu!

GJYLNARI: Oh, qënkam caktuar për tē qënë plaçkë! Nuk paskam tē drejtë tē gëzoj as sa shpezët. Qënka caktuar tē vishem si rrobë e re ditën e Nevruzit dhe tē flakem si leckë një ditë më vonë! Sa e ligë që jam! Kështu si unë vuajnë dhe shumë tē tjera! A mos vallë do tē gjendeshin për tē gjitha, burra tē dashur dhe trima që t'i shpëtonin? Vetëm mos harro arnaut, se tē desha me gjithë shpirt! Ti je i lirë, por mos harro se prapa kafazeve dergjen në ndyrësirën e Haremeve, nga dëshira për liri...

SKËNDER: Fale zëmrën e ushtarit, Hanëm!

GJYLNARI: Zëmra jote do tē rrahë për punë tē mëdha dhe unë jam krenare që e dashurova. Lamtumirë Arnaut dhe kujtomë!

SKËNDER: Lamtumirë

(Skënderbeu e përshëndet fisnikërisht dhe de andej nga erdhi. Gjylnari vetëm. Mbrëmja ra. Ushtrija kalon. Jashtë skenës dëgjohen barabanët dhe patkojtë e kalorësis : Është Hamzai që niset. Turma ngadalë largohet dhe shuhet, Gjylnari ka humbur. Asgjë nuk dëgjohet.)

GJYLNARI: Mbaroi! (shikon rrrotull dhe trembet). E vetëme e vetëme! Çdo gjë mbaroi! Sa e përqafova embëlsisht jetën, duke e pritur me padurim e mall, mbarova fare e s'mbeta veçse një kufomë. Megjithse lindim lakuriq veshim qindra fatkeqësira që nuk i meritojmë. Filloi zëmra të më rrahë, si vala shkëmbin, e trupi të më dridhesh embëlsisht prej ethesh të pakuptuarshme, dhe, sa ndjeva dashurin, mbarova . . .  
(Heshtje. Myezini këndon në minare) — Mbrëmja bije, yjtë ndrijnë dhe njeriu padashur e ndjen vehten fare të vettuar, kurse mëndja çan hapësirën dhe përqafon ata që duam ! Gufon zëmra nga dashurija ndërsa fillat i hollë, duke ngatëruar leshrat, puth faqet, ballin, gushën dhe përkëdhel shpresat !  
Ndjejmë se jemi vetëm ! Bretkocat guasin, qyqja përmallëshëm qan, një frikë na pushton!  
Mblidhemi pas vehtes atë duke kujtar ! ! . . .

(Larg ndihet kënga në tavernë :

Dita ngadal shkoi	O burra të pimë
Ra nata e qetë	Mbushe dhe një herë
Gjithçka e mbuloi	Se më nuk do vijmë
Dhe njerinë vetë.	Téi a shtrojm' sipërherë.

Asgjë të mos shohim  
Nga bota rrëmeti,  
Burra t'a kullojmë  
Sa t'bëhet qahmeti.

O burra të pimë . . .

(Ndihen të qeshura të forta dhe prap qetësi).

GJYMNARI: Por këtë mbrëmje jam krejt vetëm, e braktisur pa shpresë.

Shpirti më digjet nga vëtmija dhe nga klithmat për rrëth. Mbeta si kufomë e gjallë! Ç' më duhetjeta e përbuzur? ! Më mirë të vdes! Të vdes? ! Jo jo! . . . Jam akoma e re dhe jetën nuk e kam gëzuar! Po ç' të gëzoj? ! Turpin? ! Qejfin e Haremit? Llomin shtazor? Më mirë me mijra herë vdekja! Ai shkoi dhe për mua mbaroi çdo gjë! Plaçkë për shtratin e Sulltanit!!! Jo! . . . Më mirë ujërat e lumi! Ato janë më të ngrohta nga shtrati i Sulltait! Lamtumirë jetë! Lamtumirë gjithshka kam dashur! Pritmë, o lumë — shtrat i nusëris!

(Hidhet. Dëgjohet rënia dhe zhurma shuhet ngandal  
(Pas pak hyjnë me nxitim Eunuku, roje, një njeri  
i reckosur dhe një dado plakë me ferekhe)

EUNUKU: (Njeriut të reckosur) Si ishte vajza që pe?

NJERIU: Dukej shumë e bukur si nga fytyra ashtu dhe nga ormat e trupit.

EUNUKU: Me saktësi kur e pe?

NJERIU: Nuk ka shumë kohë: Sa të shkosh këtu e te ura e madhe.

EUNUKU: Fol drejt e mos gënje, se do të presim kokën!

NJERIU: Për Allah nuk gënjej.

EUNUKU: Ku e pe?

NJERIU: (Tregon me gjisht andej nga erdhën) Ja atje. Unë shkoja tutje kurse ajo vinte këtej. Ku shkoi nuk e di.

EUNUKU: Shpërndahuni në të katër anët dhe kërkoni;

(Rojet shpërndahan nga të gjitha anët. Aty mbitten Eunuku, dadoja me ferekhe dhe njeriu e reckosur).

- DADOJA : ALLAH, mos e gjejë gjë çupën !
- EUNUKU : Pusho ti ! (Njeriut të reckosur) Se mos na  
gënjen qafir !
- NJERIU : Jo, për Allah . . .
- NJË ZË : (Nga jashtë) Një gjë duket n' ujë !
- NJË TJETËR : (Nga jashtë) Çvishu dhe hidhu n' ujë.
- ZERI I PARE : (Nga jashtë) bëni gati litarët se po hidhem  
(Eunuku afrohet tek bregu)
- DADOJA : E zeza mos është mbytur çupa ? !  
(Edhe gruja plakë afrohet tek bregu ndërsa njeriu  
i reckosur shikon se nuk po ia vë veshin njeri dhe  
dhe largohet fshehurazi).
- NJË ZË : (nga jashtë) E zura ! Femër ! Tërhoqnan !
- EUNUKU : E gjallë është ?
- ZERI : (Nga jashtë) Jo ! Është mbytur
- DADUA : Oh, çupa ime e mjerë ! pëllumbesha ime gë-  
zim i dados plakë ! Si vdiqe dhe e le ,pas  
për të pirë helmin dadua t' ende ? !! . . . .

P e r d j a

AKT' I IV-të

Sken' e parë

Nish Kamp'i Hungarezve. Çadra e Janosh Hynia-  
dit e ndriçuar nga pishtarë. Përmes daljes së  
çadrës duket Hëna që me dritën e saj të zbehtë  
shton ndriçimin. Në derën e çadrës, pak larg, është  
një dru madhështor me degët si tëndë. M' at' anë  
lumit duken zjarret turke.)

(Në çadër janë disa oficerë të lartë Hungarezë.  
Dëgjojnë një këngë të përmallëshme që vjen nga  
një ushtar i kampit Hungarez).

### KËNGA E USHTARIT HUNGAREZ :

Kur ti, në mesnatë, qiellin ton' shikon,  
Kur fryn fillad' i lehtë, kur yjt' sipër ndrijnë,  
Kënga ime, vjen ty të përqafon,  
të flet për mua, të sjell dashurinë.

Nga larg të përshëndes,  
Ndofta s', të takoj,  
Në qoft' se në luftë mbes  
Mos të të hidhëroj  
Se me Lirin do t'rroj !

Vallen, që një herë, loznim me gëzim  
Në shesh' e livadhe, lozeni pérherë,  
Nënave u hiqni ç'do re dhe trishtim  
Se si neve kanë me qindra të tjerë.

E dashur mos qaj –  
do jem n' ato vënde,  
me lulet në Maj,  
në re e tufan –  
dhe në zëmrën tënde! –

Me kujtimin tonë bijtë na i rrisni,  
në djep kur i tundni këngën u këndoni, –  
këngën që ne lamë, gjakun ua ndisni,  
për liri të ngrihen, mike, i mësoni ! –

O këng', atje shko  
Bashk' me dashurinë,  
Vajzën përqafa,  
Përshëndet shtëpinë –  
Dhe gjith' Hungarinë !

(Hyn një grup oficerësh të tjerë dhe përshëndesin)

OFICERI PLAK : Hyniadi nuk qënkérka këtu?

OFICERI I PARË : Ka dalë për kontroll!

OFICERI PLAK : Po këshilla ushtarake?

OFICERI I PARË : Tashti si kur ka ardhur.

### G r u p t j e t ë r :

OFICERI I PARË : A i pe Arpad dritat m' at'anë lumit?

OFICERI I DYTË : Kampin e turqeve do të thuash?

OFICERI I PARË : Po!

OFICERI I DYTË : I shikova bile me kujdes. Duken sikur ënjë vënd priten, si kur janë dy kampe. Pan mje të bukur japin natën.

OFICERI I PARË : Dhe objektiv të bukur më duket.

OFICERI I TRETË : Thuhet se ushtrija armike është e ndarë në dy komanda!

OFICERI I RI : Hyniadi ynë do t' ua ndreqi qejfin të dyjave.

OFICERI PLAK : Mos harroni se njëri nga ata është Skënderbeu....

NJE OFICER : Hyniadi po vjen!

(Të gjithë shikojnë përmes daljes. N'erësirën e natës, i ndriçuar nga hëna, duket Janosh Hyniadi me armaturë të bardhë. Ecën ngadalë dhe me hapa të sigurta. Kur arrin nën pemë, ndalon dhe mendohet sikur një ide e re i shkëlqeu. Kthehet përnjëherësh dhe shikon kampin turk duke kërkuar me sy imtësisht.

NJË OFICER : Ç'bëjnë vallë turqit në këtë orë?

OFICERI I RI : Pushoni zotërij! Hyniadi madh po mendon!!!

### H e s h t j e

(Hyniadi kontrollon dhe kthehet për të hyrë në

çadër. Në këtë kohë një njeri hidhet prej errë-sirës në derë të çadrës dhe matet të qëllojë me thikë Hyniadin. Ky i fundit i a kap dorën dhe, me fuqi, e flak përtëj në krahët e oficerëve të tij që e çarmatosin dhe e ulin më gjunjë).

HYNIADI : (Me përbuzje) Shpirt-varfër ! Ç' gjë të shtyri që u ule kaq poshtë ?

SËRBI : (Ngre kokën dhe e shikon me urrejtje) Urrejtja !

HYNIADI : Jo urrejtja po Brankoviçi !

SËRBI : (I dëshpëruar) Jo ! jo ! ! – Unë vetë donja të të vrishnja ! Në pyjet tona të lira nuk mund të shkelin kurrë Hungarezët ! Unë jam sërb dhe Brankoviçi është ati ynë !

HYNIADI : Në pyjet tuaja të lira ! Vegël e ndyrë dhe e djallëzuar ! Pyjet dhe arat tuaja janë të Turqve tashti dhe ne kemi ardhur që t'ua këthejmë prapë. Çupat tuaja, me motrën e mbretit në krye, po stolisin harem e turqve. Dhe ti më flet për pyjet tuaja të lira ! Sa t'a paguan mjeshterinë tënde Brankoviçi ? !

SËRBI : Jo, nuk më ka paguar Brankoviçi ! Unë e bëra me kokën time ! Ty, kalorës i bardhë, nuk të shah dot ! Im vëlla është vrarë kundër jush ! Nuk t'a fal gjakun e tij !

HYNIADI : Renegat ! Familje renegatësh ! Di ç'bën Gjergj Brankoviçi : në mes të renegatëve i zgjedh veglat e tij. Po ti dëgjoi dy fjalë ! Dikur, pas betejës në fushën e Kosovës, një sërb që quhej Millosh, mori gjakun e shokëve të rënë dhe të vëndit të tij: vran Sultan Muratin e l-rë. Djemtë si ai s'janë mbaruar në Serbi. Ti nuk je sërb, Ti je vegël e turqve dhe e Brankoviçit ! Për njerëzit si ti nuk ka atdhe ! Ti nuk je vetëm ! Në ty shoh Muratin e Brankoviçin ! Ti je tradhëtar, shok e vegël tiranësh ! Ti je

skillav! (Befas e në mënyrë të prerë) Hiqeni!  
(Dy oficera të rinj e nxjerrin jashtë sérbin. Të  
tjerët ndjekin me vëmënd e Hyniadin).

HYNIADI : (Ulet qetësish në krye) Zotérinj, véllezér dhe  
shokë! Kemi një detyrë të shenjtë pér të  
pérmbushur, po shumë të rëndë: Të ndalojmë  
atë lumë të tèrbuar turk që po vërvhon  
n' Europë. Armiku eshtë para nesh, m'at  
anë lumi, dhe zjarret, besoj – të gjithë i  
patë mirë. (Disa bëjnë shenjtë se po) Ju  
thira në këshillë që të vendosim, pasi t'a  
shohim, veprimin e mëtejshëm. Armiku ka  
rezerva të shumta dhe pa tjetër do të dër-  
gojë edhe të tjera fuqi kundër nesh. Ja pse  
u thirra zotérinj! Tashti sejcili të flasë me-  
ndimin e tij se si të veprojmë.

OFICERI I DYTË : (Arpad) Zotérinj! I pashë me vëmëndje  
zjarret e kampit turk dhe më duken si dy  
vatra të mëdha. Të mos presim asnjë mi-  
nutë por të hidhem i në mes të të dyjave  
dhe t'i shuajmë. Ky eshtë mendimi im. Të  
sulmojmë dhe me një herë.

OFICERI I RI : Bukur foli! I lumtë! Të sulmojmë Hyniad i  
i madh, t'u futemi si pyka dhe t'i dërmojmë!  
Zhurmë e përgithëshme Nga ç' do anë ndihen:  
«Po, po! T'i sulmojmë! «T'u futemi si pyka!» «T'i  
shuajmë!» «T'i dërmojmë».

NJË OFICER : T'i dërmojmë që Sulltan Muratit t'i sillet  
çallma në kökë dhe mos të dijë nga t'ia  
mbajë.

OFICERI I RI : Kahramanët dhe të tjerët do të ngrihen. Tu  
bjemë Hyniad i madh dhe t'i fshijmë. Të  
mos shohin më nga sytë që të vijnë.

(Hyniad bën shenjtë dhe zhurma  
pushon)

**OFICERI PLAK :** Trimërija është kurdoherë e nderuar por vlera e saj matet nga përfitimi që jep. Po tē hysh midis dy zjarreve digjesh. Nuk duhet t'a marrim punën me gjakra tē nxehura. Para nesh është Skënderbeu dhe kalorija e zgjedhur turke. Unë mendoj se do tē jetë më mirë t'i sulmojmë nga krahët dhe t'i fshijmë njerin pas tjetrit, tē dy gjeneralët turq. Po që tē futemi në mes tē tyre ..... Më falni po kjo nuk më duket punë e mënçur. Tē kesh në njerin krah kalorësit e tēr-buarë dhe në tjetrin Skënderbenë duhet që tē tē bëjë tē mendohesh pakë. Unë e mbyll fjalën time tē shkurtër duke propozuar që tē sulmojmë nga krahët dhe mundësish – sikur t'a dinim – jo n'atë që komandon Skënderbeu.

(Të gjithë tē tjerëve u prodhon efekt tē ndryshëm. Disa e aprovojnë, kurse tē tjerët dhe oficerii ri jo. Ngrihet Hyniadi..... Qetësija mbretëron.

**HYNIADI :** Zotérinj! I dëgjova dhe një herë këshillat tuaja me vlerë dhe dëshirat t'uaja tē zjarra. Armiku që kemi përpara është i fortë dhe komandohet nga duar tē sigurta. Ne na duhet t'a sulmojmë pa i dhënë kohë që tē na godisi më parë. Prandaj unë urdhëroj....  
(Përjashta ndihet zhurmë. Hyn oficeri i rojes).

**OFIC. I ROJËS :** Një përfaqësi shqiptarësh kërkon Hyniadin e madh. (Habi në tē gjithë).

**HYNIADI :** Le tē hyjnë!

**NJË OFICER :** Mos janë vullnetarë që luftojnë kundër turqëve ?!

**NJË TJETËR :** Unë mendoj se mos kanë ardhur tē zemruar nga renegati i tyre për t'a luftuar,

TJETËR OFIC: Erdhën!

(Hyjnë dy shqiptarë me kostume kombëtare. Të gjithë nderojnë përfaqsinë. Përvendesin Hyniadin dhe mbledhjen.)

SHQIPTARËT: Ju ngjatjeta burra!

HYNIADI: Mir' se erdhët.

SHQIPTARËT: (Hyniadit) Zot' i nderaur! N' emërtë Njeriut që na ka dërguar, dhe të popullit shqiptar, vijmë t'u afrojmë miqësinë dhe aleancën t' onë.

HYNIADI: Kush nga kryetarët t' uaj ju ka dërguar?

SHQIPTARËT: Kjo është një e mëshehtë shumë e rëndësishme. Vetëm për ju na është besuar një letër, zot' i nderaur.

(I dorëzon letrën Hyniadit. Ky e lexon dhe habitet shumë.)

HYNIADI: Komandantat Ishtvan, Gabor dhe Arpad të mbeten. Të tjerët të na falin për pak kohë.

(Dalin të gjithë dhe mbeten Hyniadi, dy shqiptarët, oficeri plak, Arpad (ofic. II-të) dhe oficeri i ri (Gabor)

HYNIADI: Shokë; Letra që më ra në dorë ka një rëndësi të madhe. Përpara se t' ju njoftoj përbajtjen e saj, dua t' ju bëj të ditur se kush e dërgon: Letrën e dërgon – Gjergj Kastrioti – Princ shqiptar.

OFIC. PLAK: Këtë njeri nuk e kemi dëgjuar ndonjë herë. Gjon Kastriotin po.

SHQIP. DYTË: Është i biri.

HYNIADI: Po, është i biri. Turqit e kanë marë peng që kur ishte foshnjë si dhe djemtë e tjerë të Gjon Kastriotit; gjithë jetën e ka shkuar në shërbim të Sulltanit në Turqi, dhe është e para herë që dërgohet në Perëndim. Tashti mban emrin Skënderbej.

(Të tre oficerat habiten)

OFICERI RI: Skënderbeu ? ! . . .

ARPAD: Komandanti turk e dërgon ? ! . . .

OFIC. PLAK: Skënderbeu, komandanti i gjysmës s' ushtrisë

që kemi për ballë e dërgon këtë letër ? ! . . .

SHQIP. I PARË: Gjergj Kastrioti është bir i maleve t'ona, i  
yni dhe do të jetë me ne. Ai me kohë po e  
pret rastin që t' aratiset. Tashti erdhi ! Mjafton  
që të dy popujt tonë t'a lëshojnë grushtin dhe  
hordhit e Sulltanit bëhen pluhur. Bjeruni t'u  
bjemë, miq mazharë, se akoma u dhëmbin  
brinjët nga Arianiti.

HYNIADI: Ne, do të bëjmë ç'do gjë që është e mundur.  
Shokë vërtet Kastrioti është sot një nga ko-  
mandantët e Turqisë, por unë besoj se mund  
të mbështetemi në fjalën e tij. Besëlidhja ku-  
ndër turqve ka nevojë për 'të.

OFIC. PLAK: Atëherë, në se na lejohet, nuk mbetet veçse  
të lexojmë letrën.

(Dy të tjerët pohojnë me kokë.)  
Dëgjoni !

I dashur dhe i shkëlqyer

ZOTËRI DHE KAPITEN !

Ju bëj të ditur, se fuqija që keni përballë, përbëhet nga njëzet mijë ushtarë të ndarë në dy komanda : Krahun e djathtë e komandon Karabeu dhe të majtin, që përbëhet nga dhjetë mijë ushtarë, unë. Kjo fuqi nuk është veçse pararoja e fuqisë qëndrore që po vjen me Sulltanin vetë. Çdo vonesë nga ana e juaj, jo vetëm nuk sjell dobi, po ju dëmton. Kaloni lu-  
min dhe sulmoni krahun e majtë, ku ndodhem

unë, dhe do të kini një fitore të sigurtë e të plotë mbi gjithë ushtrinë turke.

Ditë e re po agon! Do të zhduken retë turke dhe shi gjaku nuk do të bjerë më mbi vëndet tona! Rrugën e mbarë të përparimit ku ka hyrë Europa nuk do t'a ndalojë kurrë çallma turke! Popujt po bashkohen dhe e afërtë është dita kur do të ulen si vëllezër të mirë e të dashur në sofrën e madhe të tyre! Agimi po zbardhëllen pas errësirës turke! Erdhi koha që errësirën historike t'a hapim me shpatat tona!

*Ju përshëndes*

GJERGJ KASTRIOTI.

HYNIADI : Letra, zotërij, është kjo.

OFIC. I RI : Kastrioti na fton për një punë të lartë. Unë mendoj se duhet të hidhemi përt' a grisur errësirën e historisë.

ARPAD : Gjersa punët qëndrojnë kështu, duhet të hidhemi.

OFIC. PLAK : Edhe unë ashtu mendoj.

HYNIADI : (Shqipëtarëve) Thuajni udhëheqësit tuaj Kastriotit se e pranojmë propozimin e tij dhe se do të sulmojmë. Për siguri të çështjes letër nuk po ju apim.

SHQIP. I PARË : Ju vaftë mbarë burra. Mbeçi me shëndet!

HYNIADI : Rruja e mbarë. Përshëndetje udhëheqësit tuaj nga ana e ime dhe e popullit tim.  
(Përshëndetën dhe Shqiptarët dalin.)

OFIC. PLAK : Po sikur të jetë grackë?

HYNIADI : Nuk besoj. Ai nuk i harron vëllezrit e vrarë.  
Pastaj pozita jonë kërkon që të sulmojmë dhe

të sigurojmë një aleat të ri, që do ta kemi aleat të sigurtë. Hungarija ka prapa saj Gjermaninë dhe Shqipërija detin dhe Venedikun. Përpara Shqipërisë dhe Hungarisë është Turqija, kurse në mes tonë është Papa me Vatikanin që mbjellë përçarje për të sunduar gjoja mbretërinë shpirtërore. Mos harroni, zotërinj, se si Venediku ashtu dhe Papa do të na bëjnë varrin kur të kenë hedhur hendekun. Prandaj aleancë e të dy vëndeve është e natyrëshme dhe duhet të forcojmë për të mirën e popujve tanë. Pastaj, si do që të jetë, fuqinë sulmonjëse e mbështesin me një rezervë të forte.

OFIC. PLAK! Turqit nuk do t'a sulmojnë më Hungarinë se u zbulojnë krahët Shqipëtarëvet.

OFICER'I RI: Po ç' presim Hyniad i madh? Urdhurona të sulmojmë!

ARPAD: Urdhërona të sulmojmë, Hyniad i madh!

HYNIADI: (Ngrihet.) Lajmëroni komandantët të vijnë!

AFPAD: (Arpad del dhe thërrët që nga dera e çadrës,) Zotërijtë komandantë të urdhërojnë!

(Arpad dhe të gjithë të tjerët hyjnë në çadër.)

HYNIADI: Zotërij dhe shokë! Urdhëroj që me dhjetë mijë luftëtarë të fillojë sulmi me një herë.

OFIC. I RI: Rroftë Hyniad' i madh!

TË GJITHË: Rroftë!

HYNIADI: Të pregatiten forcat me një herë!

(Të gjithë dalin.)

Kambanat e shekullit po bjenë për ngjarje të mëdh-a! Shumë larg do të shkojë ky gjeneral i madh! E ardhëme e madhe e pret!

Britmat e luftëtarëve po e ngrejnë shekullin!

P E R D J A

SKEN' E II-të.

Nish. Kamp'i turqëve. Çadra e Qatipit pak më larg nga kampi i ndriçuar prej një pishtari.  
Qatipi dhe dy oficerë.

OFIC I PARE: Pa tjetër nesër.

QATIPI: Po do të ishte më mirë të më kishin vënë edhe mua në dijeni.

OFIC. I DY.: Ndofta nesër mblidhet këshilla ushtarake.

QATIPI: Këshilla mblidhet pér të gjithë kurse unë jam një nga të tre.

(*Dy oficerët mbledhin supat.*)

Sido që të jetë, nesër takohemi prapë. Natën e mirë.

OFIC. I DY.: Natën e mirë.

OFIC. I PAR: Të mirë e të émbël e bëfsh.

(*Oficerët dalin. Qatipi mendohet.*)

P U S H I M

QATIPI: Më mirë është që ta nisë sa më parë.  
(*Përplas duartë. Hyn një ushtar dhe nderon.*)

C'kemi?

USHTARI: Asgjë hazretleri. Asnjë lëvizja të dyshimtë.

QATIPI: Shiko mirë hajvan se Skënderbeu ua hedh edhe cave më të zotët se ti!

USHTARI: Mos ki merak hazretleri; se kam vënë që t'a ruajnë njerëz të zotët, të cilët kontrollojnë edhe ajrin që ai nuhat.

QATIPI: Shumë mirë. (Mendohet.) Shiko! Më dërgo një njeri të besuar pér një udhëtim të largët. Të jetë më i fortë se çeliku dhe më dinak nga dhelpëra.

USHTARI: Si urdhëron, hazretleri.

QATIPI : Shko tashti, dhe hapni sytë! I bëni katër!  
(Ushtari i çuditshëm del. Qatipi mer letër dhe kallamarin dhe ulet të shkruajë... Fillon një potere e tmerrëshme luftë. Dëgjohen klithmat e luftëtarëve dhe tringëllimat e shpatave që afrohen.

. . . Qatipi vetëm . . . )

QATIPI : Pa sikur? . . . Allahu mos e dhëntë! . . . Po sikur të thyhem? ! (Ngrihet nga vëndi dhe shkon në derë.)  
Po jo! Nuk ka si thyhem! - Hyra keq! - Hej asqer!

(Hyn një ushtar.) Si shkon lufta?

USHTARI : Sa po filloj hazratleri dhe britmat pona afrohen.  
T' a pres gjuhën, qën!

USHTARI : Pasha hazretleri, kështu më duket! Urdhëroni vëtë e shihni në se nuk më besoni!

QATIPI : Mirë. Del e ruaj dhe më trego çdo gjë që të ndodhë.

(Ushtari matet të dalë.) Kalin ma ke gati?

USHTARI : Gati i shaluar, hazretleri.

QATIPI : Mirë. Del dhe hap sytë e më njofto me një herë çdo gjë. (Ushtari del. Qatipi bën lëvizje të shqetësuara. Ulet dhe ngrihet prapë. Britmat afrohen.) U thyem më duket! Ç'kemi asqer? (Ushtari ka ikur. Nga të gjitha anët dëgjohen hapa njerëzësh dhe këmbët e kuajve. Dëgjohen britma të vazhduarshme: «Ikni! Ikni! Të shpëtojë kush të mundë!» Eh, asqer qëni! Ike! ? Po s'ke ku të shkosh! Do të të gjej . . . (Matet të dalë.)

Do të të gjejë edhe . . .

(Në derë çfaqet Skënderbeu. Qatipi tmerrohet prej asaj pamjeje dhe prapset. Skënderbeu e

ndjek ngadale gjersa tënda e ndalon Qatipin të shkojë më tej.)

SKËNDERBEU : (I afrohet fara afër. Ndihet frysë-marrja e të dyve.) Mirëmbërëma Qatip ! A merzitesh ? (Qatipi rri si i vdekur.) Siç duket nuk prisje të takoheshim !

QATIPI : (Buzëqesh me pahir,) Skënderbej, mos u thyem ?

SKËNDERBEU : U thyet Qatip !

QATIPI : Po atëhere ç' presim ? Duhet që të . . . :

SKËNDERBEU : Ikim ? – Do t'ikësh Qatip, po më parë do të më lash një børxh të vogël pér hatër (Më lironi) të miqësis sonë.

QATIPI : (Gjithënë duke buzëqeshur me zor.) Jam shumë i gëzuar t'u çfaq dashurinë time duke ju shërbyer !

SKËNDERBEU : Mos u bëni merak se do të shpërbleheni gjithëashtu Qatip. Mëhyrin me fermanin e Sulltanit e ke me vehte ?

QATIPI : Pse ?

SKENDERBEU : Përgjegju Qatip !

QATIPI : Ju më tmerroni !

SKENDERBEU : Akoma jo. (Kërcnjonjës.) Përgjegju të them !

GATIPI : (Duke u dredhur) Me vehte e kam.

SKENDERBEU : Mer letër dhe ulu në fron !

QATIPI : Nuk e kuptoj qëndrimin tuaj !

SKENDERBEU : Do t'a kuptosh. Mer letër dhe ulu !

(Qatipi ulet në fron. Vë përpara letrën e pregatitur që më parë dhe pret.)

Mere kallamarin në dorë !

(Qatipi gjithënë duke u dredhur mer kallamarin.)

Shkruaj !

QATIPI : Pres urdhër bej !

SKENDERBEU : «Me urdhërin tim» . . . (Qatipi shkruan.) . . . «t'i dorëzohet Skënderbeut» . . .

QATIPI : O ollah ! O allah i madh ! Po si mund t'i shkruaj këto rrjeshta kur e di mirë se Padishahu do të ma presë kokën ! ?

SKËNDERBEU : Nuk do të ketë kohë. Shkruaj! (Qatipi shkruan.) . . . „me të parë fermanin“ . . . (Qatipi shkruan) . . . „kalaja e Krujës“ . — Pikë. — „Çdo kundërshtim do të dënohet egërsisht si shëmbull.. E shkrove ?

QATIPI : E shkrova.

SKËNDERBEU : Vulose me mëhyrin !

QATIPI : Hezretleri, doni të më humbisni ?

SKËNDERBEU : Vulose të them !

QATIPI : Padishahu do të më . . .

SKËNDERBEU : Vulose!! (Qatipi e vulos dhe ia jep. Rrotull çadërës kalojnë ushtarë turq, të thyer, duke bërrtitur vazhdimish: «Të shpëtojë kush të mundë» ! — Skënderbeu kontrollon fermaçin dhe e vë në brez. Qatipi gjen kohë të nxjerrë thikën për t'a goditur. Skënderbeu kthen kokën. Qatipi i tmerruar matet të ikë. Skënderbeu e arrin.)

SKËNDERBEU : T' erdhi koha të lash gjynahet Qatip !

QATIPI : Aman ! Falmë !

(Bije në gjunjë.)

SKËNDERBEU : E mbushe kupën me kohë !

QATIPI : Aman, falmë ! . . . Oooo !

(Shpata bije. Klithma shuhet së bashku me 'të. Skënderbeu fut shpatën në mill dhe drejtohet në të dalë të çadërës. Lindja ka nisur të zberdhëllehet)

SKËNDERBEU : Po agon ! Turqija mbeti pas si një ëndërr nga e cila u zgjova në jetë ! Mbaruan pabesitë ! Tashti s' kam më nevojë të los me Sultanin dredharak !

Ëndrra e keqe mbeti pas ! — Po me 'të mbeti dhe një kujtim i dashur ! — Ajo po fle në

tokën e ftohtë, në errësirë, dhe nuk do të zgjuhet kurrë ! Nuk do t' a shohë më dritën ! –  
(Te dera e çadrës duket Hamzai me shqiptarin që pamë në Turqi të veshur me kostum shpiptar.)

HAMZAI : Treqind malësorët po presin në maja.

SKËNDERBEU : Nata po ikën dhe po zbardh agimi. Drejt Shqipëris o burra !

### PËRPARA

(Skënderbeu me shqiptarin dalin. Hamzai i mbetur vetëm hyn në çadër nga ka dalë.)

HAMZAI : Përpara ? ? ! . . . Po ku ? ! . . . Ç' gjëndje e cuditëshme ! Rrotull bërtasin e vritten si bagëtitë, dhe pse ? Vetëm për një fron. As s'do të kenë ç' të përgjigjen në dritën e gjyqit të tmerrshëm ! Kope bagëtish ! Sa mirë ! Unë jam i vetëm dhe i qetë ! Unë jam në një anë me një njeri që vdekja i vuri vulën e më të përulurit në botë. (I afrohet Qatipit..) Ej, Qatip ! Zgjohu ! Pse më fle kur rrotull po vazhdon vallja e përgjakëshme ? ! i harrove planet e tua ? ! Sa çudi ! Ajo kokë hartonte plane për mbi plan kurse një shpatë u vuri pikë para se të zbatoreshin ! . . . Ej, zhurmë ! Zhurmë që as vehtja të mos më dëgjojë ! . . . Hë, ku e kishim Qatip ?, Po planet ! Vdiqën në kokën tënde po degë po çojnë në kokën time, dhe mos harro se shpatën e kam në dorë ! – Një fron ? Një mbretëri ? Ah jo ! Unë dua që të tok' e qiell' e ferr ti los siç po los kjo natë me këtë kope që më rrethon ! – Mos më dëgjo o zot ! . . . – (Një kalorës shkon afër çadrës duke brritur.) Erdhi koha ! (I vë këmbën në gjoks qatipit.) Le të shkojmë drejt fatit, Hamza ! – (Kalon e ndalet). Përpara ? !

... Po, po! Kështu më duket se dëgjova! —  
(Del.)

P e r d j a

A K T' I P E S TË

Krujë. Natë. Në sallën e madhe në kala, Hasan  
bej Vërzezhda ka gasti. Pak në krahun e majtë  
është dere që nxjerr në shesh të kalasë. Dëgjo-  
het një këngë turke me zëra të mbytyra. Në ta-  
volinë ka rregull. Salla ndriçohet nga shumë pish-  
tarë që i bëjnë më të dobëta hijet e njerëzve që  
vallëzojnë në muret. Herë pas here oficerët u he-  
dhin qënve copa mishi jashtë skenës.

(Hyn një oficer turk dhe nderon).

OFICERI: Bej, — allahu të rrítë jetën, — fuqija e jote u  
godit me shqiptarët në rrethet e Krujës.

HASANI: Kur?

OFICERI: Tashti bej Askeri vajtën të marrin ca bagëti  
po barinjtë i goditën.

HASANI: Dhe pastaj ç'u bë?

OFICERI: U vranë pesë asqerë bej, kurse nga barinjtë  
*u vra vetëm një.*

HASANI: Sa veta ishin?

OFICERI: Dy barinj, bej. Tjetri mundi t'ikë pasi i dha  
mundësi edhe familjes që të largohet. Qafiri  
bile i mori dhe të vëllait kokën.

HASANI: Të shkatërrohen gjithë familjet rrotull kala-  
së, sa kur të dal në beden, të mos më zëre  
syri asgjé!

OFICERI: Si urdhëron bej!  
(Nderon dhe del).

TJETËR OFIC: Po me familjet që kemi brënda në kala çdo të bëjmë?

HASANI: Të gjitha do t' i çfaros! (Ngre gotën me sherbet). "Padishah" – "Zil-ullah"»!

TË TJERET; Allah!

(Vazhdon ahengu. Një vallëtare kërcen ndërsa bije defi dha llauta. Sherbetorët sjellin kanistra me pemë. Të gjithë qeshin dhe dëfrenë. Hyn oficer i shërbimit.)

HASANI; Ç' eshtë?

OFICERI: Te port' e kalasë ka ardhur një lajmëtar nga Sulltani!

HASANI: Tashti eshtë natë. Nesër hapet porta.

OFICERI: Ja thamë po ai u përgjegj se ka urdhër shumë të shpejtë dhe të rëndësishëm dhe po të mos hapet porta sot, do të përgjigjemi përrapa Zil-ullahut. Ka fermanin e Padishahut, – allahu i rrithet jetë dhe i forcoftë krahun!

HASANI: Le të hyjë!

(Zhurmë e përgjithëshme. Njérëzit bisedojnë grupe grupe. Hasani pret me pa durim).

### N j ë g r u p

OFIC. I PARË: C' do vallë lajmëtarin natën?

OFIC. I DYTË: Mos të nisemi gjëkundi?

OFIC. I TRET; Sigurisht kërkohet fuqi kundër Hungarezëve, Kjo do të jetë!

OFIC. I DYTË: Pa tjetër. Edhe unë ashtu mendoj.

### G r u p i i d y t ë

OFIC. I PARË: Se mos sulmojnë këtej nga ne?

OFIC. I DYTË: Kush të sulmojë?

OFIC. I PARË: Si kush të sulmojë? Hynaidi me të besëlidhurit e tij të pabesë.

OFIC. I TRET: Nuk ma mer mëndja!

OFIC. I KAT. Në këto vende të mallkuara çdo gjë mund të ndodh.

G r u p i i t r e t ē

- OFIC. I.I.: Siç duket nuk shkojnë mirë punët me hungarezët!
- OFIC. I.II.: Hesht qafir! – Allah na ndihmo!
- TË KATËR: Allah-il-allah!
- MYFTIU: (Hasanit). Mos bëhet ndonjë ndryshim në kala?
- HASANI: Jo. Nuk ma ha mëndja.
- MYFTIU: Mos kemi bërë ndonjë gjë që nuk i ka pëlqyer Padishahut? . . . Ajo e sotmja, përshëmbull! . . .
- HASANI: (Qesh) Ajo tashti sa ndodhi, si e mori vesh Padishaho?
- MYFTIU: Bej, Padishahu i mer vesh që të gjitha nga vetë zoti!
- HASANI: Unë kam frikë se mos ka ndodhur ndonjë kryengritje në këtë vënd të mallkuar!

(Hyn oficer' j shërbimit)

- OFICERI: Lajmëtar i Padishahut!  
Të gjithë marrin qëndrim nderimi. Hasani rri rendë në krye të vendit. Hyn Hamzai i veshur si oficer i lartë i ushtrisë turke, bën një nderim mjaft ceremonial, dhe, pasi e puth fermanin ia dorëzon Hasanit).
- HAMZAI: Ferman nga sultani!  
(Hasani e mer, e shikon dhe, pasi e puth, e e vë në ballë tri herë, ia dorëzon myftiut përt'a lexuarë).
- MYFTIU: (e puth e e vë në ballë tri herë dhe e lexon)  
«Me urdhërin tim, t' i dorëzohet Shënderbeut, më të parë fermanin, kalaja e Krujës. Çdo kundërshtim do të dënohet me egërsi si shëmbull».  
Mban vulen e Zil-ullahut, Padishah i turqve dhe i gjithë botës, – ullahu i rritë jetën dhe forcoftë krahun!

- HAMZAI (Me madhështi) Skënderbeu, komandant' i k拉斯ë së Krujës kërkon të takojë Hasan bei Vëzehdën!
- HASANI: Mirse të urdhërojë!  
(Oficeri i ceremonisë ngre shkopin me skiper; hyn Skënderbeu. Të gjithë bijen më gjunjë. Hasani bën një nderim të thellë).
- SKËNDERBEU Padishah
- TË GJITHË: Çok jasha!  
(Skënherbeu shkon tek Hasani i cili ia liron vëndi pa dashur).
- SKËNDERBEU Armiqësit e vjetra tashti duhet t'i harrojmë, Hasan bei. Pleqtë e bënë punën e tyre, kurse ne do të bëjmë tonën.
- HASANI: Si urdhëron Skënderbej. Gjithnjë kam patur qejf t'u nijnja.
- SKËNDERBEU Gjithëashtu edhe unë.
- HASANI: Po unë tashti çdo të bëj?
- SKËNDERBEU Do të presësh fermanin e Sulltanit. Nuk besoj që të vanohet shumë. (Të gjithëve) Oficerë, bejlerë dhe agollarë! Sot dhe nesër jeni të lirë nga shërbimi. Lajmëroni dhe asqerin se janë të lire. Harxhet e défrimit janë mbi mua.
- TE GJITHE: Allahu i rritë ymrin Skënderbeut, beat tonë!  
(Dalin të gjithë të gëzuar).
- SKËNDERBEU (Hasanit) Hasan bei mund të shkosh për t'a qetësuar, pa punët i shikojmë nesër me ditë. si ka urdhëruar allahu.
- HASANI: Si urdhëron.  
(Përhëndet dhe del).
- SKËNDERBEU (Shikon rrotull dhe pasi sigurohet se nuk e dëgjon njeri, flet) Hamza, gjer këtu erdhëm mirë po më të zorëshme e kemi përpara.
- HAMZAI: Da t'a kalojmë xhaxha.
- SKËNDERBEU Do t'a kalojmë sigurish po nuk është gjë e lehtë. Kemi treqind vetë jashtë mureve, po

po nuk u ngritën burrat brënda në kala nuk  
kemi gjë.

HAMZAI : Do të ngrihen porsa t'a marrin vesh.

SKENDERBEU Duhet t'i zgjojmë sa më parë se sulltani mund  
t'a ketë kuptuar dhe na ka vënë kalorës nga  
pas. Që në këtë natë duhet t'i japim fund punës  
Ti shko fshehtas shtëpi më shtëpi dhe thuaju  
t'i nxjerrin armët e t'i fshijnë. Brënda pak  
kohe duhet të jenë gati. Pasi t'i kesh lajmëruar  
shko e udhëhiq të jashtëmit, dhe në shenjën  
time, sulmo përmes portës së hapur. Shkatërrro  
dhe asgjëso çdo gjë që të gjejsh përpara.  
Vetëm me mënd se nga pa kujdesija më e vo-  
gël përbysen plane sa do të mëdhaja qofshin.  
Nuk do t'i lëmë që të përbysen. Tashti unë  
po largohem për te Kruetanët.  
(Përjashta dëgjohet zhurmë).

SKENDERBEU Ç' është kjo?

HAMZAI : Më duket se po vijnë kruetanët!

SKËNDERBEU Po vijnë vetë: Urdhëro që të hyjnë, (Hamzai  
del). Sa mirë! Kur e muarën vesh!

HAMZAI : (Nga jashtë) Komandant i Krujës, urdhëron  
që të lihen të hyjnë qytetarët!

SKËNDERBEU Ashtu! Tashti do të njihemi Murat!

(Hyjnë Hamzai dhe qytetarët. Më plaku mban të  
mbështjellë një kulaç në një shami të madhe dhe  
të bukur).

PLAKU : Nuk dimë kujt ja sjellim bukën dhe kripën:  
Beut turk apo të birit të malevet tonë.

SKËNDERBEU Mos vallë bejlerët turq u kini shpurë kuleçë  
më parë?

PLAKU : Vetë kanë ardhur dhe kanë marë gjithë ha-  
mbarët po ne nuk u kemi shpurë asnjë thë-  
rrime.

SKËNDERBEU Dhe kurrë nuk da t'u shpini! Erdhi koha t'i

lajmë hesapet një herë e mirë me Sulltanin.  
Erdhi koha të ngrihem o burra!

PLAKU: (Shikon shokët. Të tjerët i shkelin synë duke buzëqeshur. Plaku shkon te Skënderbeu) Thye je kulaçin, biri im!

Skënderbeu thyen kulaçin dhe ve në gojë bukë e kripë: pastej e vë në tavolinë. Oytetari plak i hidhet dhe puth duke thënë. «Biri im! Biri im! Skënderbeu puthet me të gjithë përzëmërisht. Plaku qan).

SKËNDERBEU Mos qaj atë, Shqipërija nuk vdes kurrë!

PLAKU: Po shumë nga tanët nuk janë më që ta shikojnë të lirë!

SKËNDERBEU Ata janë dhe do jenë gjithënjë me ne! – Burra, mblidhni vehtën se përparrë nesh kemi punë shumë të rënda!

PLAKU: Asgjë nuk na trëmb! Jemi gati të vijmë vetë, me gjithë djemë dhe gratë tonë, për të luftuar armikun dhe për të vdekur si burra në fushen e nderit

TJETËR QYT.: Do të ngrihem që të gjithë nën Komandën tënë!

TJETËR: Edhe të vdekurit do të ngrihen nga varret!

SKËNDERBEU Me të tiilë burra fitorja është e sigurtë. Po, t'i matim forcat: Sa burra mund të llogarisim nga qyteti?

PLAKU: Pesqind burra!

SKËNDERBEU Dhe treqind përjashta, tetë qind. Mjaftojnë! Si fillim janë mjaftë! Veç nuk duhet të humbasim kohë burra. Armiku nuk na jep lirinë më të mirë, prandaj duhet t'ia marrim me forcë!

PLAKU: Urdhërona dhe do ië bëjmë çdo gjë.

TË GJITHË: Jepna urdhër!

SKËNDERBEU Shkon shtëpi më shtëpi dhe thuajuni të ngirë-

hen. Nxirni armët e vjetra dhe bëhuni gati që kur të nxjer pishtarin te dera, të vërviteni mbi turqit dhe t'i dërmoni! Do të sulmoni me një herë portën kryesore, vrisni rojet, dhe hapeni që të hyjnë ata që janë përjashta. Shkoni tashti dhe u vaftë mbarë burral! Ti Hamza shko më ta.

HAMZAI: Po me ty?! . . .

SKENDERBEU Unë jam komandanti i qytetit dhe nuk më gjen gjë. Shkoni burra, shkoni! Na vaftë mbarë!

(Dalin të gjithë. Skënderbeu, si mbetet vetëm shikon sallën, shikon çdo gë dhe mallonet nga kujtimet)

Ja! Më së fundi në vendin ku linda! Ja dera ku vëllezër e motra bashkë prisnim babanë kur këthehej. Më duket sikur jam në endërr. Sikur ndodhi dije dhe sikur nuk ishja unë që ishja në Turqi. Më duket sikur kam jetuar këtu gjithë jetën!

Këtu kanë jetuar Kastriotët! Shtëpija e ime, vëndi, im!

Këtu çdo gjë më flet për Shqipérinë! Sa herë këta mure e kanë parë atin tim të menduar! Sa mendime të tij janë mbyllur në këta mure! – Përgjigjuni mure! – Mure, heshtin, po unë ua kuptoj porosinë e plakut. Fli i qetë ati im, nuk janë shpërndarë në erë mendimet e tua! Përpjekjet e tua s'janë mbaruar: ato do të vazhdojnë me mua dhe pastaj me bijtë dhe nipërit tanë!

(Shkon pran oxhakut. Shikon flakët e zjarrit dhe me dorë lëmon gurët e oxhakut) Sa herë jemi ngrohur këtu! (Bije në gjunjë) Të falem o zjarr i vatrës së prindëve të mij! Nëna e imel Shtëpija ime, në thjeshtësinë tënde unë shoh ata

që janë të gjallë në zemrën time! (Ngrihet e shkón në dritore i pangopur me sa e rrethon.) Oborrin e ka mbuluar errësira:  
(I afrohet murit dhe e prek me dorë.) Gur' i vëndit tim! I ftohtë! Si nuk plase duke dëgjuar mburrjet dhe sharjet e turqve? Përgjigju! Fol!  
Fol Shqipëri! Ti dukesh e heshtur po fjalën tënde je gjithmonë gati ta thuash! Zëri ytësh-të i tmerrshëm për armiqtë! Po ta dëgjoj zërin!  
Kambanat po bjenë dhe gjithë Shqipërija po ngrihet! Le ta dëgjojë shekulli zërin e Shqipëtarit!

(Hyn Hasani. Skënderbeu e ndryshon përnjëherë.)  
Allah, ndriçoi rrugën osmanllisë! Fuqija jonë mos paftë kufi!

HASANI: Allah-il-allah!

(Hasani afrohet si me dyshim)

Më lejoni t'u çfaq një mendim?

SKËNDERBEU: Do të jem i kënaqur t'a dëgjoj.

HASANI: Ju, me sa kam dëgjuar, keni shërbyer shumë kohë në Anadoll. Duket andej mbretëron qetësija!

SKËNDERBEU: Nuk ju kuptoj!

HASANI: Doja t'u thoshnja se andej populli është më i urtë dhe në besën e allahut, kurse këtu jemi vazhdimisht si në gjëndje lufte. Sa të mbylliësh sytë kur përnjëherësh ngrihen.

SKËNDERBEU: Me sa kam dëgjuarë, unë more bej, ti këtu ke ardhur me fermanin e Sulltanit. si shpërblim për babanë që u vra për këto mure. Kurse unë në Anadoll luftoja. Edhe andej nuk shtrohen more bej, dhe zjejnë si një kazan sa herë që u jepet rasti, se njerzit nuk mbrehen si qetë. Po ti ke të drejtë. Nuk ke luftuar dhe prandaj nuk i di.

HASANI: (Kafshon buzët nga inati.) Në Anadoll nuk

kam qënë po e di se sì duhen ruajtur muret  
e kalasë së Krujës!

SKËNDERBEU: Ti e di, po unë e dua!

HASANI: Do vërtet që t'i ruash po kështu si janë asgjë  
nuk i ruan

SKËNDERBEU: (E shikon drejt në sy.) Pse?

HASANI: Se të gjithë, që nga i pari e gjer te i fundit,  
flejnë ose bëjnë qejf.

SKËNDERBEU: Gabohesh Hasan bej! Këto mure nuk ka  
fuqi që i merr se janë tonat!

HASANI: Po atëhere, — më fal që po ndërhyj kaq the-  
llë në punën tënde, — si ndodh që të gjithë  
pa përjashtim i le të lirë?

SKËNDERBEU: Prap gabohesh more bej, jo të gjithë!

HASANI: Si jo të gjithë?! Ti vetë e dhe urdhërin përp-  
para të gjithë oficerëve!

SKËNDERBEU: Mere pishtarin dhe del në derë të shikosh  
se si ruhen muret e Krujës dhe sa rëndë  
gjenjehesh!

(Hasani është më dysh, Mere, merel!)

(Hasani mer pishtarin dhe del në derë. Pa pan-  
dehur e gjithë kalaja u trondit nga britmat «Liri,  
liri» që çanë errësirën e natës. Në portat dhe në  
muret fillojnë luftimet. Britmave «Liri, liri» u përgje-  
gjën ato «Allah, allah!». Dëgjohen vringëllimat e shpa-  
tave. Hasani e ka humbur, kthen kokën dhe sheh  
se Skënderbeu po qesh.)

HASANI: Ç' do të thotë kjo, Skënderbej?

SKËNDERBEU: Dëgjoje! Dëgjoje sa bukur ushton në errësi-  
rën e natës! Dëgjoje si po e grris! (Vazhdon  
të qeshë. Nuk kishje dëgjuar Hasan bej!)

HASANI: (E mbledh vehten) Si?!... Ti?!...

SKËNDERBEU: Të thashë Hasan!» Pleqtë e bënë punën e  
tyre kurse ne do të bëjmë tonën»,

HASANI: (I tērbuar nga inati) Ah, gjaurl...

(Hasani shkul shpatën. Skënderbeu bën gjithashtu.)  
SKËNDERBEU; (Skënderbeu vazhdon të qeshë) Mbrohu Hasani se të erdhi fundi!

HASANI: Ah, gjaurl....

(Fillon dyluftimi. Skënderbeu e sulmon rrebtës, me siguri dhe me taktkë. Hasani është mbledhur dhe dredh shpatën i humbur, pa siguri dhe duke klithur me grykë: «A a a z! Aa! A a a a al» Skënderbeu e fut te cepi dhe me një qëllësë e lë në vënd. Në këtë kohë hyn një grup turqsh. Skënderbeu lëshohet mbi' ta, Luftim me shpata; Skënderbeu i vë përpara dhe i nxjerr jashtë që të gjithë, Nga ana tjetër hyn një grup shqiptarësh me shpata në dorë dhe shkojnë pas tij, Një erë e fortë i shuan pishtarët, errësirë.)

(Lufta vazhdon te porta e kalasë. Turqit qëndrojnë egërsisht te porta kryesore mbi të cilën valon akoma flamuri turk. Natë. Në beden, poshtë te porta, dhe te sheshi, shqiptarët janë ngatërruar me turqit. Në mes të zhurmës së luftës ngrihen thirrjet e të dy palëve. Një shqiptar e pret me shpatë shtizën e flamurit turk. Shumë turq janë shtrirë për tokë. Zhurma e luftës dalëngadalë shuhet dhe agimi fillon të zbardhëllejë lindjen. Qetësi. Dritë. Fillojnë të grumbullohen njerëz dhe të dëgjohen zëra burrash grash dhe fëmijësh.)

ZËRI I PARË: Sillini këtej !

ZËRI I DYTE: C'i mbani? Vrajini të gjithë !

ZËRI I TRETE: Ushtarët e marë me zor jo !

ZËRI I KATËR ; Gjyq !

ZËRA :

Gjyq Gjyq për renegatët! Të vriten tradhëtarët!

(Në këtë kohë dëgjohen «Rroftë Gjergj Kastrioti», Rroftë udhëheqësi ynë! — Dhe me një herë në të gjithë kalanë valëviten flamurët Shqiptarë. Britmat «Rroftë Gjergj Kastrioti» bëhen më të forta dhe kuptohet se ai po vjen në popull, Skënderbeu vjen te sheshi i veshur me kostumin e njojur. Disa vajza të veshura me kostume kombëtare. vijnë e i dhurojnë lule dhe sende të qindisura. Duket qelli i kaltër dhe majat e mbuluara me borë e të ndriçuara nga dielli. Të gjitha ngjyrat përzihen dhe jepin një pamje madhështore. Skënderbeu hipën mbi një pirg.)

SKËNDERBEU: Kapedanë dhe ushtarë trima!

Popull i Shqipërisë!

Nuk është as e re, dhe as e papritur pamja që më paraqisni sot. Ashtu si u kam kujtuar, ashtu u gjej stërnipër të një fisi të vjetër dhe fisnik, heroj të pa thyer të tokës suaj. Sot unë jam i lumtur që mund t'u hap zëmrën time. Kur u këthenja pa shpresa, juve mund t'u ketë shkuar ndërmënd q' e kisha harruar vëndin tim. Nderin dhe lirinë. E them para të gjithëve, se gjithë jetën kam ushqyer dashurin e madhe për atdheun dhe lirinë.

Lirinë ju mund t'a kishit fituar me heroizmin tuaj, edhe me ndonjë tjetër udhëheqës, se Shqipërisë nuk i mungojnë heronjtë, po u pëlqeu t'a fitonim së bashku, me gjithëse me vonesë, Lirija ishte në majat e shpatave tua ja në ballë dhe në zemër. Nuk ua prura unë, po e gjeta në mes tua j.

Pjesa më e madhe e punës është kryer; Kruja me të gjithë territorin e saj, janë në duartë tonë; Dibra dhe melësija janë me ne. Rezistojnë vetëm fortesat. Ne do të lëvisim më parë kundër Petrelës, jo sepse ajo është më e lehta, sepse është një fortesë natyrale dhe ka një garnizon të fortë, po ajo është më e afërta nga kryeqyteti dhe lajmet e Krujës do t'a demoralizojnë shpirtin e armikut. Armiku, i demoralizuar nga heroizmi juaj dhe nga ngjarja e garnizonit të Krujës, ka mundësi të na i lëshojë pa luftë; në rast të kundërt do t'a marrim me sulm! Një gjë nguleni në mëndjen tuaj: Ose do të jemi zotër të Petrelës, ase do të bijëm nën muret e saj!

Shpalosni flamurët, ngrijini lartë dhe tregohuni si përherë burra!

Trimërija dhe e drejta që na ndihmuani gjer më sot, do të na ndihmojnë gjer ne fitoren e plotë!

## P E R P A R A !

(Britma triumfale  
marsh triumphal)

## F U N D

Leningrad 1949 — Tiranë 1950